



## DHP ËSHTË PJESË E PROGRAMIT TË INSPEKTORËVE TATIMOR PA KUFIJ

Shkup, 5 prill viti 2024

Drejtoria e të Hyrave Publike është pjesë e nismës së Inspektorëve Tatimorë pa Kufij, projekti i cili realizohet në bashkëpunim me OECD-në - Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik dhe UNDP-në - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara.

Drejtoresha e Drejtorisë së të Hyrave Publike, Sanja Lukarevska, me këtë rast, falënderoi Sekretariatit e inspektorëve tatimorë pa kufij për miratimin e aplikacionit për bashkëpunim, ekspertin z. Sanjev Sharma, i cili do të punojë me inspektorët në fushën e tatimeve ndërkombëtare dhe çmimeve të transfertave, dhe në veçanti me OECD-në dhe UNDP-në për ofrimin e mbështetjes në zbatimin e këtij projekti.

Lukarevska theksoi se në një kohë kur vendet kanë nevojë në rritje për të hapur kufijtë e tyre për tregtinë dhe investimet ndërkombëtare, është thelbësore që vendet të mund të vendosin tatimin mbi fitimet që bëjnë kompanitë brenda vendit pa dekurajuar ose shtrembëruar tregtinë ose investimet ndërkombëtare.

Me ndihmën e kësaj nisme, ne po forcojmë kapacitetet e DHP-së për të përcaktuar taksimin e drejtë, bazuar në parimin "shtrirja e krahut", një standard që ka rezultuar të jetë praktik dhe i balancuar si për administratat tatimore ashtu edhe për tatimpaguesit, dhe me të cilat çmimet e transfertave mund të vlerësohen ndërmjet ndërmarrjeve të lidhura dhe të palidhura, në kushte dhe rrethana të ngjashme ekonomike, duke parandaluar kështu taksimin e dyfishtë dhe evazionin fiskal.

Në afat të gjatë, do të kontribuojë gjithashtu në një klimë më të favorshme investimi, do të bëjë të mundur ndërtimin e një kulture të pajtueshmërisë mes tatimpaguesve përmes ekzekutimit dhe mbledhjes më efektive të të ardhurave në buxhet. – tha Lukarevska.

Përfaqësuesi i përhershëm i Programit të Kombeve të Bashkuara për zhvillim (UNDP), në RMV z. Armen Grigorjan tha se kjo nismë është vazhdimësi e bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet UNDP-së dhe DAP-it në fushën e menaxhimit të financave publike.

Mbështetja gjithëpërfshirëse e UNDP-së në fushën e tatimeve ndërkombëtare dhe çmimeve të transferimit ka hedhur një bazë të fortë për përmirësimin e administratës tatimore në Maqedoninë e Veriut, duke siguruar përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke inkurajuar një rritje të qëndrueshme ekonomike, dhe në të njëjtën kohë duke forcuar përpjekjet tona për zbatimin e Objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht objektivat 16: Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta dhe 17: Partneritete për qëllime.

Na vjen mirë që përmes nismave të tilla kontribuojmë në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe formimin e partneriteteve për forcimin e sistemeve tatimore, përmirësimin e mobilizimit të burimeve vendase dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm. – tha Armen Grigorjan - përfaqësuesi i përhershëm i Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në vendin tonë.

Udhëheqësi i departamentit për marrëdhënie dhe zhvillim global në Organizatën për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD), z. Ben Dickinson, theksoi se me ndihmën e Projektit, Drejtoria e të Hyrave Publike, në periudhën e ardhshme do të ketë mundësi me mbështetjen dhe ndihmën e drejtpërdrejtë të ekspertit Sanjev Sharma, për të përmirësuar kapacitetet e inspektorëve tatimorë për zbatimin e kontrollit të çmimeve të transfertave.

Në event u prezantuan rezultatet e deritanishme, dhe u sqarua se në këtë program në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në kuadër të Inspektorëve Tatimorë pa kufij, inspektorët tatimorë përmes



mbështetjes së ekspertëve në periudhën e ardhshme do të fitojnë aftësi për të kryer kontrolle konsistente tatimore të ndërmarrjeve shumëkombëshe dhe në këtë mënyrë do të kontribuojnë në përballjen me sukses të evazionit fiskal dhe shmangies së tatimeve nga sipërmarrjet shumëkombëshe.

Fjalimin e kishte edhe eksperti i programit, Sanjev Sharma, i cili sqaroi se përmes këtij bashkëpunimi, si ekspert do t'i bartë njohuritë dhe aftësitë e inspektorëve maqedonas, dhe të cilat përcaktohen në përputhje me programin e Inspektorëve Tatimorë pa kufij dhe asistencën teknike për kontrollet tatimore ndërkombëtare.

Aktivitetin e ndoqën edhe donatorët e Drejorisë së të Hyrave Publike, përfaqësues nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore dhe Thesari i SHBA-së.

Programi i Inspektorëve Tatimorë pa kufij është një iniciativë e nisur nga Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (OECD) dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në vitin 2015 dhe synon të mbështesë vendet në zhvillim në trajtimin e evazionit fiskal të përhapur dhe shmangies së taksave nga ndërmarrjet shumëkombëshe. Deri më tani, iniciativa numëron 59 programe aktuale dhe 73 të përfunduara.